



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

**1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar** me datë **06.08.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin në gjyq të çështjes penale me nr. 78/2023, në ngarkim të të pandehurve **Ismail Zeneli, Bujar Ajeti, Adrian Cenaj (Dedja), Dedan Gjoni, Besmir Murtati, Albert Prenga, Jonida Babameto dhe Erzen Breçani**”.

2. Në seancën e datës **27.12.2024** (seanca paraprake), Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtare Irena Gjoka, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve, me vendimin Nr. **109**, datë **27.12.2024**, vendosi:

I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për dërgimin në gjyq, të çështjes penale që i përket procedimit penal me Nr. 78, viti 2023, në ngarkim të pandehurve:

1. **Ismail ZENELI**, hetuar me masën e sigurimit personal “*Arrest në burg*”, e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në formën e veçantë bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grupi i strukturuar kriminal*”, “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/1 dhe 334/1 (dy herë); “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, “*Grupi i strukturuar kriminal*”, “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 80, 28/4, 333/a/1 dhe 334 të Kodit Penal.

2. **Bujar AJETI**, hetuar me masën e sigurimit personal “*Arrest në burg*”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprave penale “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, kryer në formë të veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*”, “*Kryerja e veprave nga penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” të parashikuara përkatësisht nga nenet 80, 28/4, 333/a/1 e 334/1 të Kodit Penal; “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*” parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal; “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i*

*armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*” parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal; *“Përkrahja e autorit të krimit*” parashikuar nga neni 302/2 i Kodit Penal.

- 3. Adrian CENAJ (DEDJA)**, hetuar me masën e sigurimit personal *“Arrest në burg”*, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprave penale *“Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje”*, kryer në formë të veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, *“Grup i strukturuar kriminal”*, *“Kryerja e veprave nga penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”* të parashikuara përkatësisht nga nenet 80, 28/4, 333/a/2 e 334/1 të Kodit Penal.

- 4. Dedan GJONI**, hetuar me masën e sigurimit personal *“Arrest në burg”*, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprave penale *“Trafikimi i narkotikëve”* kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, *“Grupi i strukturuar kriminal”* dhe *“Kryerja e veprave nga penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”*, të parashikuara përkatësisht nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal; *“Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje”* në dëm të shtetasve A.N dhe E.N, kryer në formë të veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal *“Grup i strukturuar kriminal”* dhe *“Kryerja e veprave nga penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”* të parashikuara përkatësisht nga nenet 80, 28/4, 333/a/2 e 334/1 të Kodit Penal; *“Shpërdorimi i detyrës”* parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

- 5. Besmir MURTATI**, hetuar me masën e sigurimit personal *“Arrest në burg”*, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprave penale *“Trafikimi i narkotikëve”* kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, *“Grupi i strukturuar kriminal”* dhe *“Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”*, të parashikuara përkatësisht nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

- 6. Albert PRENGA**, hetuar me masën e sigurimit personal *“Arrest në burg”*, e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprave penale *“Trafikimi i narkotikëve”* kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, *“Grupi i strukturuar kriminal”*, dhe *“Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”*, të parashikuara përkatësisht nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal.

- 7. Jonida BABAMETO**, hetuar me masën e sigurimit personal *“Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”*, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe “*Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete*” parashikuar nga neni 295/a/1 i Kodit Penal.

8. **Erzen BREÇANI**, hetuar me masën e sigurimit personal “*Arrest në burg*”, (nga data 20.11.2023 deri në datën 16.06.2024) dhe aktualisht me masën e sigurimit “*arrest në shtëpi*”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale.

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprave penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale*” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287/1/b/2 i Kodit Penal; “*Përkrahja e autorit të krimin*”, parashikuar nga neni 302/2 i Kodit Penal.

- II. Dërgimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me tjetër trup gjykues.
- III. Fashikulli i gjykimit do të përmbajë të gjitha aktet e hetimit paraprak, të përfshira në 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) volume hetimore.
- IV. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit **Bujar Ajeti**, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe armëve sportive*” parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal, për shkak se vepra penale është amnistuar, bazuar në nenin 6 të Ligjit Nr. 33/2024 “*Për Dhënie Amnistie*”.
- V. Kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk lejohet ankim, ndërsa kundër vendimit për pushimin e akuzës mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

**Tiranë, më datë 27.12.2024**

**Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**